

## Prof. dr. DHIMITRI BELLO



Dhimitri Bello është profesor me kohë të plotë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës dhe profesor i ftuar në Universitetin e Korçës. Studimet „bachelor“ (dega filologji) dhe „master“ (gjuhësi e zbatuar) i ka kryer në Universitetin „Neofit Rilski“, Bllagoevgrad, Bullgari.

Në vitin 2002 ka mbrojtur doktoraturën në Akademinë e Shkencave të Bullgarisë me tezën *Leksiku i përbashkët i ballkanizmave me prejardhje turke në bullgarisht dhe shqip (modelimi strukturor-semantik)*, nën drejtimin e albanologes së shquar bullgare Petja Asenova (konvertuar nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor „Doktor i Shkencave“ në Republikën e Shqipërisë). Në vitin 2013 merr titullin “profesor” në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë.

Karrierën e ka filluar si pedagog për lëndët „gjuhë shqipe“ dhe „histori e gjuhës shqipe“ në Universitetin „Neofit Rilski“ deri në vitin 2001, në vitet 2002-2010 ka qenë pedagog me kohë të plotë në Universitetin „Fan S. Noli“ të Korçës dhe në vazhdim pedagog i ftuar; që nga viti 2010 është pedagog me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë.

Ka drejtuar departamentin e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Korçës dhe departamentin e gjuhësisë në Universitetin e Tiranës.

Ka qenë anëtar i disa organeve kolegjiale, si anëtar i Këshillit të Fakultetit në Korçë dhe në Tiranë, anëtar i Këshillit të Administrimit në Korçë, anëtar i Këshillit të Profesorëve, Tiranë; është anëtar i këshillave botuese të disa revistave shkencore në Korçë, në Tiranë, në Bullgari etj.

Ka kryer specializime afatshkurtra në disa institucione të huaja, si në Gjermani, Greqi, Bullgari etj. Në vitin 2010 ka qenë pedagog i ftuar në Universitetin „Sv. Kliment Ohridski“ të Sofjes ku ka zhvilluar kursin special të gjuhësisë ballkanike. Në vitet 2012-2014 punoi si pedagog me kontratë në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit për lëndët histori e gjuhës shqipe, leksikologji dhe morfologji.

Prof. Belloja dallohet për veprimtari të frytshme shkencore dhe botuese si autor dhe bashkautor në disa libra; ka botuar në revista të ndryshme shkencore mbi 25 artikuj në fushën e gjuhësisë ballkanike, gjuhës shqipe dhe bullgarishtes; ka marrë pjesë me kumtesa më mbi 45 veprimtari shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

Ai ka udhëhequr disa doktorantw në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin e Korçës etj.

Ka marrë pjesë si anëtar dhe koordinator në mbi 12 projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e gjuhësisë ballkanike, toponimisë, etnolinguistikës, mësimdhënies, edukimit në distancë etj.

Kandidon për herë të parë në detyrën e Rektorit.